

VLERËSIMI I KOMUNITETIT PËR QEVERISJEN

RAPORT BASHKIA VLORË



RAPORT

VLERËSIMI I KOMUNITETIT PËR QEVERISJEN 2016

BASHKIA VLORË

SHËNIM I RËNDËSISHËM

Ky raport u përgatit me:

Mbështetjen financiare dhe teknike të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID). Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Dhe me

Mbështetjen financiare dhe teknike të Njesisë së Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), në kuadër të programit “Lidershipi dhe Pjesëmarrja Politike”. Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze nëpërmjet Fondit të Koherencës së Kombeve të Bashkuara dhe është pjesë e “Programit të Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016”. Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e UN Women, të Agjencive të Kombeve të Bashkuara apo të Qeverisë Suedeze.

AUTORËT

Raporti u përgatit dhe u hartua nga ekspertët e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillim të Qendrueshëm dhe të Integruar (QZHQI), me mbështetjen dhe asistencën e:

Laureta MEMO, Eksperte për Angazhimin Qytetar dhe Komunikimin, USAID/ Projekti i Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore

Fiorela SHALSI, Menaxhere e Programit Kombëtar “Lidershipi dhe Pjesëmarrja në Politikë”, UN Women

Të drejtat e publikimit

© Aplikimet për lejen për të riprodhuar ose përkthyer të gjithë ose një pjesë të këtij studimi duhet bërë në zyrën e GADC-së me adresë:

Rr. Abdyl Frashëri”, P.10/1, shk.1, ap.3

E-Mail: gadc@gadc.org.al

www.gadc.org.al

TABELA E PËRMBAJTJES

MIRËNJOHJE	5
SHKURTIME	6
1. HYRJE	7
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
3. PROFILI I BASHKISË VLORË	9
4. METODOLOGJIA	11
5. PËRSHKRIM I PROJEKTIT	13
6. PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE	16
7. GJETJET KRYESORE PËR PERIU DHËN 2015-2016	18
7.1 GJETJET NË QYTET:	18
7.2 GJETJET NË NJËSITË ADMINISTRATIVE	19
8. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	20
8.1 KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME PËR QYTETIN	20
8.1.1 Shërbimet Publike – Cilësia dhe Efiçenca	20
8.1.2 Demokracia Vendore dhe Mirëqeverisja	21
8.1.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor	21
8.1.4 Respektimi dhe zhvillimi i të drejtave të njeriut në nivel lokal	21
8.2 KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME PËR NJËSITË ADMINISTRATIVE	22
8.2.1 Shërbimet Publike – Cilësia dhe Efiçenca	22
8.2.2 Demokracia Vendore dhe Mirëqeverisja	23
8.2.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor	23
8.2.4 Respektimi dhe Zhvillimi i të Drejtave të Njeriut në Nivel Lokal	23
RRETH QENDRËS ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM	25

MIRËNJOHJE

Ky raport u përgatit nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (QAGJZH) në bashkëpunim me Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe të Integruar (QZHQI). Me mirënjohje falënderojmë të gjithë ata që ndihmuan në realizimin e këtij raporti për të vlerësuar qeverisjen vendore dhe gjithë qytetarët e Bashkisë Vlorë, të cilët morën pjesë aktive në aktivitetet e realizuara përmes projektit dhe përmes argumentave vlerësuan mirëqeverisjen lokale për bashkinë e tyre.

Një falënderim i veçantë i shkon z. Dritan Leli dhe stafit të tij të cilët morën angazhime konkrete përballë qytetarëve bazuar në sugjerimet e tyre për përmirësimin e punës në Bashkinë e Vlorës. Gjithashtu, falënderimi i shkon edhe Komisionit Këshillimor Qytetar Vendor Vlorë për angazhimin vullnetar në këtë proces dhe jo vetëm.

Një falënderim shkon edhe për mbështetësit dhe financuesit e këtij projekti, Programit të Kombeve të Bashkuara për Gratë në Shqipëri, UN Women dhe Projektit të USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) për mbështetjen financiare dhe teknike gjatë zbatimit të projektit.

SHKURTIME

NJQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
KKQV	Komisioni Këshillimor Qytetar Vendor
OJF	Organizata Jo-Fitimprurëse
QAGJZH	Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”
RAT	Reforma Administrative-Territoriale
VKQ	Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen
UN Women	Programi i Kombeve të Bashkuara për Gratë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

1. HYRJE

Ndërkohë që po bëhet progres për avancimin e procesit të decentralizimit në Shqipëri, sfidat për zbatimin me sukses të qeverisjes vendore të decentralizuar e demokratike janë të mëdha. Reforma Administrative-Territoriale (RAT) që filloi të zbatohet në qershor të vitit 2015, pati ndikim të konsiderueshëm në funksionimin dhe administrimin e njësive të qeverisjes vendore (NJQV). Zvogëlimi i numrit të NJQV-ve nga 373 në 61, çoi rrjedhimisht në rritjen ndjeshëm të territorit, popullsisë dhe kompleksitetit të funksionimit të tyre. Ndikimi i reformës është i madh, jo vetëm në aspektin e përgjegjësive dhe funksioneve të shtuara të njësive vendore, por edhe në ofrimin e shërbimeve me cilësi dhe efikasitet për qytetarët e bashkisë së zgjeruar tashmë. Paralelisht me këtë, bashkitë tani përballen me sfida edhe më të mëdha se më parë për të arritur informimin, përfshirjen dhe përfaqësimin e vërtetë të grave dhe burrave në vendimmarrje.

Në këtë kuadër, që prej vitit 2015, Projekti i USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) dhe UN Women, në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile dhe Komisionet Këshillimore Qytetare Vendore (KKQV) kanë ndërmarrë projektin e Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen (VKQ) në 10 nga bashkitë më të mëdha në vend. Në pritje të reformës dhe zgjedhjeve vendore të vitit 2015, VKQ u zbatua në bashkitë e Elbasanit, Beratit, Kamzës dhe Vlorës, ku gjetjet dhe rekomandimet e qytetarëve gra dhe burra u prezantuan dhe u përfshinë në axhendat dhe programet e kandidatëve për kryetarë bashkie. Këtë vit, VKQ u zbatua në gjashtë bashki të reja: Fier, Gjirokastrë, Kuçovë, Vlorë, Lushnjë dhe Shkodër. Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen përfshin aspekte kryesore të qeverisjes vendore, të tilla si: (I) cilësia dhe efikasiteti i shërbimeve publike; (II) qeverisja e mirë dhe demokracia lokale; (III) zhvillimi ekonomik dhe (IV) të drejtat e njeriut në nivel vendor.

Përmes vjeljes së opinioneve të qytetarëve në identifikimin dhe përcaktimin e prioriteteve lokale, VKQ synon të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetare në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale. Procesi i VKQ mundëson monitorimin dhe vlerësimin e performancës së administratës lokale, paralelisht me ndërtimin e urave të dialogut, ndërveprimit dhe bashkëpunimit në nivel vendor.

Vlerësimi i komunitetit për qeverisjen është një qasje dhe mundësi e mirë që bashkitë të kuptojnë nevojat dhe përparësitë e qytetarëve. Harmonizimi dhe përfshirja e rezultateve të vlerësimit të komunitetit në programet vendore, si dhe përpjekja për të influencuar në hartimin e politikave vendore, janë një tregues pozitiv i demokracisë në veprim. Kombinimi i metodologjisë së VKQ me aktorë kyç lokalë, të tillë si Komisionet Këshillimore Qytetare dhe organizata të shoqërisë civile kanë mundësuar zbatimin me sukses të këtij procesi.

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Informacioni i përfshirë në këtë raport prezanton ecurinë e procesit të Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen në Bashkinë Vlorë në periudhën 2015-2016 dhe përfshin vlerësimin nga ana e komunitetit dhe administratës vendore të performancës së shërbimeve të ofruara në nivel vendor, si dhe gjetjet dhe rekomandimet e ardhura nga qytetarët. Prosesi i VKQ-së i ofron Bashkisë Vlorë një tablo të qartë të vlerësimit të qytetarëve në lidhje me shërbimet publike, zhvillimin ekonomik, funksionimin e demokracisë vendore dhe të drejtat e njeriut në nivel lokal.

Procesi i Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen u realizua nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH) në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, njësitë administrative Orikum, Novoselë, Shushicë dhe Nj.A Qendër, me pjesëmarrjen e Komisionit Këshillimor Qytetar Vendor Vlorë dhe komunitetit në njësitë administrative të sipërpërmendura.

Projekti Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen u shtri në harkun kohor 2015-2016 dhe përfshiu 10 bashki, ndër të cilat edhe Bashkinë Vlorë. Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i demokracisë vendore përmes fuqizimit të mekanizmave qytetarë. Objektiva specifike të tij synojnë të nxisin ndërveprimin dhe dialogun mes qytetarëve dhe autoriteteve vendore, përmes përfshirjes së prioritetëve dhe nevojave të qytetarëve në programet dhe buxhetet vendore, duke krijuar kushte për përmirësim të qëndrueshme të shërbimeve që i ofrohen komunitetit dhe duke fuqizuar në këtë mënyrë bashkëpunimin midis të dyja palëve.

Për realizimin e VKQ u punua ngushtësisht me administratën e bashkisë për të siguruar gatishmërinë dhe bashkëpunimin e tyre në proces, gjë që kërkoi takime dhe diskutime paraprake në lidhje me metodologjinë, fushat që trajtonte VKQ, zonat e përzgjedhura për zbatim dhe pjesëmarrjen qytetare në të. Në bashkërendim me Bashkinë, zonat e zgjedhura për të realizuar VKQ ishin njësitë administrative Vlorë, Orikum, Novoselë, Shushicë dhe Nj.A Qendër. Vlen për t'u theksuar kontributi i çmuar i Komisionit Këshillimor Qytetar.

Gjatë procesit të përpunimit të vlerësimeve janë konsultuar gjerësisht materiale, dokumente dhe strategji, të tilla si: Draft Strategjia e Zhvillimit të Territorit, buxheti i bashkisë për vitin 2016, Plani i Punës së Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020, Ligji 119/2014 Për të Drejtën e Informimit, Ligji 135/2015 për Organizimin dhe Funksionimin e Vetëqeverisjes Vendore, faqja e internetit e bashkisë, etj.

Në këtë raport do të lexoni: 1) Një profil të shkurtër të bashkisë Vlorë; 2) Metodologjinë e projektit; 3) Përshkrimin e projektit; 4) Përmbledhjen e rezultateve të vlerësimit të qytetarëve korçarë për qeverisjen vendore; 5) Gjetje e rekomandime për të ardhmen.

3. PROFILI I BASHKISË VJORË

Me miratimin e Ligjit 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Bashkia Vlorë përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Vlorë, Orikum, Qendër Vlorë, Novoselë dhe Shushicë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e Qarkut të Vlorës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Vlorë dhe Orikum) dhe 37 fshatra; në listën e fshatrave përfshihet edhe Sazani. Bashkia e re e Vlorës kufizohet në veri me bashkinë Fier, në lindje me bashkinë Selenicë dhe në jug me bashkinë Himarë. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Vlorës. Në këtë territor shtrihen tre qendra të rëndësishme të turizmit detar: Vlora, Radhima dhe Orikumi si dhe një brez blegtoral siç është Dukati. Kjo zonë ka në përbërje dhe parkun detar-bregdetar Sazan-Karaburun, që është i vetmi i këtij lloji në vendin tonë.

Popullsia: Sipas Census të vitit 2011 bashkia e re ka 104.827 banorë (Burimi: INSTAT). Gjithsesi, në regjistrin civil në këtë bashki rezultojnë si popullsi banuese prej 194.147 njerëz (Burimi: Gjendja Civile). Bashkia e re e Vlorës ka një sipërfaqe prej 616.85 km². Nga të dhënat e Census, densiteti i popullsisë në këtë bashki është 169.9 banorë për km² ndërsa sipas të dhënave të regjistrit civil, densiteti është 314.73 banorë për km². Nga të dhënat e ndryshimeve sipas NJ.A. vihet re se pjesa urbane e Bashkisë Vlore përfaqësohet nga Bashkia e vjetër e Vlorës e cila ka pësuar rritje, krahasuar me rënien e popullsisë në NJ.A. Orikum, Novoselë, Shushicë dhe Qendër. Nga të dhënat e Census 2011, struktura e popullsisë meshkuj-femra për të gjithë njësitë përbërëse të bashkisë Vlorë, ka një shpërndarje pothuajse të barabartë meshkuj-femra të popullsisë residente, gjë që tregon se flukset migratore tashmë janë stabilizuar duke eliminuar shpërndarjen jo të rregullt të popullsisë sipas gjinisë. Duke u nisur nga shtrirja e Njësive Territoriale të Bashkisë Vlorë, shpërndarja e popullsisë së Regjistrit të Gjendjes Civile na jep dhe një shpërndarje të popullsisë qytet-fshat. Në zonat urbane, kryesisht në qytetin e Vlorës janë të regjistruar rreth 71% e popullsisë, ndërsa popullsia në zonat rurale dhe gjysmë urbane (Orikumi), përfshin rreth 29% e popullsisë.

Papunësia: Të dhënat e Census-it 2011 tregojnë që papunësia në total në bashkinë Vlorë është rreth 27.0%, pak më e ulët krahasuar me nivelin kombëtar 29.3%. Po kështu niveli i papunësisë midis të rinjve në nivel bashkie është 51.5%, kundrejt 52.9% në nivel kombëtar. Shqetësues mbetet niveli i papunësisë rinore në qytetin e Vlorës me 54.1%, nivel i cili është më i lartë si në rang kombëtar ashtu dhe midis NJ.A të tjera, pjesë përbërëse të bashkisë Vlorë. Për sa më sipër dilet në konkluzionin se niveli i lartë i papunësisë në qytetin e Vlorës në krahasim me NJ.A e tjera, vjen nga fakti i zhvendosjes së popullsisë drejt qytetit duke rritur në këtë formë dhe nivelin e papunësisë. Nga të dhënat e Census 2011, në Bashkinë e re të Vlorës, femrat janë më të diskriminuara nga pikëpamja e punësimit, ato përbëjnë 31,5%, krahasuar me meshkujt që janë 24.3%.

Punësimi: Punësimi dhe shpërndarja e të punësuarve në bashkinë e re të Vlorës sipas Census 2011, llogaritet sipas tre sektorëve më të rëndësishëm që janë sektori i industrisë me 26.7%;

sektori i bujqësi/agrikulturës me 31.1% dhe sektori i shërbimeve me 60.2%. Këto të dhëna tregojnë jo vetëm shkallën e punësimit, por dhe karakterin e çdo rajoni që përbën bashkinë Vlorë. Përqindja më e lartë e punësimit është në qytetin e Vlorës, kryesisht në sektorin e shërbimeve ku janë të punësuar rreth 68.4% e të punësuarve në këtë sektor. Nj.A që kanë nivelin e punësimit shumë më të ulët dhe nxjerrin në pah dhe diferenca sociale të mëdha janë Novosela me 26.2% dhe Shushica me 30.9% me nivelin më të ulët të punësimit. Kjo shpërndarje tregon dhe karakterin e rajoneve, ku Nj.A. Shushicë dhe Novoselë mbi 50% e të punësuarve janë në sektorin e bujqësisë/agrikulturës, e pasuar nga Nj.A Qendër 41.9% dhe Oriku me 30.3%, të dhëna që flasin për karakterin rural të këtyre njësive.

Sektorë të rëndësishëm të ekonomisë

Zhvillimi Industrial: Qyteti i Vlorës është qendër e madhe demografike zhvillimi dhe punësimi, si dhe porti i dytë më i madh në Shqipëri; në të gjendet dhe një port peshkimi dhe një qendër industriale dhe tregtare që gjeneron të ardhura të lidhura me shërbimin dhe prodhimin. Ekonomia e qytetit është e lidhur me ekonominë e portit, ndërtimit, turizmit dhe shërbimeve të tjera përkatëse. Bashkia e Vlorës në zonën urbane të saj është planifikuar edhe si zonë industriale dhe petrolifere.

Zhvillimi i turizmit është theksuar si një nga sektorët prioritarë për zhvillimin ekonomik të Bashkisë Vlorë. Pozicionimi gjeografik i territorit të Bashkisë Vlorë në drejtim të zhvillimit të turizmit, veçanërisht me zgjerimin e saj me ish komunat që nga grykëderdhja e Vjosës e deri në malësinë e Llogorasë, kanë shtuar mjaft larmishmërinë dhe potencialin turistik të saj. Pozicioni i përshtatshëm gjeografik me praninë e bregdetit të Jonit dhe Adriatikut në të njëjtën bashki, ekzistenca e shumë monumenteve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore, identifikon këtë territor si zonë me potenciale të spikatura të zhvillimit të turizmit balnear, agro-turizmit, aktiviteteve të peshkimit turistik, etj. Zhvillimi i turizmit është ndër burimet më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik, ku turizmi bregdetar kombinohet mjaft mirë me turizmin kulturor. Megjithatë, për të mbrojtur trashëgiminë mjedisore dhe kulturore (të cilat janë atraksionet turistike kryesore në bashki) dhe tërheqin turistë ndërkombëtarë (të cilët presin standarde të cilësisë së lartë nga një vend që aspiron integrimin në BE) është e nevojshme të ndryshohet modeli për zhvillimin e turizmit që është ndjekur deri tani, për ta orientuar atë drejt qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale. Kjo nënkupton krijimin e një oferte turistike më të larmishme, duke futur bregun dhe zonat e thella në itineraret tematike, duke përfshirë atraksionet e ruajtura mirë si dhe akomodimin dhe shërbimet e cilësisë së lartë.

Bujqësia është sektor prioritar për zhvillimin ekonomik të Bashkisë së Vlorës, i përcaktuar si i tillë edhe në Planin e Përgjithshëm Kombëtar. Nj.A të Bashkisë Vlorë janë të orientuara drejt prodhimit lokal bujqësor. Niveli i lartë i prodhimeve bujqësore, kryesisht frutikulturë, ka ngritur punishte ose fabrika të prodhimit të vajit të ullirit dhe fabrika të prodhimit të lëngjeve, përpunimit të rrushit për verë, etj. Krahas prodhimit bujqësor në bashkinë e Vlorës edhe prodhimi blegtoral, qumështi dhe nënproduktet e tij, mishi, vezët, janë relativisht të zhvilluara dhe kanë mundësi rritje të këtij sektori në të ardhmen. Në funksion të rritjes së prodhimit bujqësor dhe në mbështetje të tij, janë hedhur hapa në zhvillimin e agro-industrisë. Në Nj.A. Novoselë ka një fabrikë të prodhimit të kripës, e cila në të ardhmen mund të rrisë kapacitetet e saj të prodhimit dhe përpunimit dhe të eksportojë në vende të tjera.

4. METODOLOGJIA

Procesi i Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen¹ është mjet monitorimi që përdor komunitetin si njësi analize për të nxitur llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë sociale dhe publike të institucioneve vendim arrëse vendore. Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen njihet ndryshe edhe si “zëri i komunitetit”, pasi i mundëson qytetarëve të shprehin vlerësimin e tyre mbi cilësinë, përshtatshmërinë dhe eficientësinë e shërbimeve publike dhe të propozojë ndryshime në lidhje me shërbimet e ofruara, madje edhe mbi vendimmarrjet vendore. Mekanizmi i VKQ-së zbatohet në një nivel teje të rëndësishëm të qeverisjes, në atë vendor, ku qytetarët janë në kontakt më të drejtpërdrejtë me autoritetet vendimmarrëse dhe mbi të gjitha, me shërbimet e ofruara prej tyre.

Procesi mundëson krijimin e dialogut mes komunitetit dhe autoriteteve vendore, duke përballur mundësitë (burimet që kanë në dispozicion autoritetet vendore) me nevojat reale të komunitetit. Zbatimi i këtij mekanizmi në nivelin vendor ndikon në: zhvillimin e demokracisë me pjesëmarrje dhe arritjen e mirëqeverisjes vendore. Duhet të theksojmë gjithashtu se VKQ-ja nuk është thjesht një proces vlerësimi, pasi shkon përtej tij. Ajo ndërton ndërveprimin mes komunitetit, autoriteteve vendore, organizatave të shoqërisë civile etj, duke krijuar kushte për përmirësime të qëndrueshme të shërbimeve që i ofrohen komunitetit, duke e fuqizuar atë.

Gjatë procesit të VKQ-së parimet kryesore të vlerësimit të shërbimit (pavarësisht nga çështja objekt i VKQ-së) do janë:

- **Përshtatshmëria:** programi apo shërbimi a i reflekton nevojat e grupit të targetuar? A i respekton standardet dhe kriteret që përcakton ligji?
- **Efiçenca:** A po përdoren burimet (financiare, njerëzore, lokale) në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur? A përfshihet komuniteti në planifikimin e këtyre burimeve?
- **Pjesëmarrja:** Sa dhe si nxitet pjesëmarrja e komunitetit në planifikimin dhe zbatimin e programit/shërbimeve? Cilat janë metodat që përdorin autoritetet për të nxitur pjesëmarrjen?
- **Qëndrueshmëria:** jetëgjatësia e programeve, shërbimeve. A janë fondet vjetore në rritje apo ato nuk ekzistojnë?
- **Rezultati:** Çfarë ndryshimesh ka sjellë zbatimi i programit/shërbimit? Çfarë rrugësh përdorin autoritetet për të matur ndikimin??

Përfituesit e Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen janë komuniteti dhe autoritet vendore. **Procesi i VKQ-së i mundëson komunitetit** të informohet mbi shërbimet që ofrohen nga autoritetet vendore; të shprehë opinionin e tij mbi cilësinë dhe eficientësinë e tyre; të monitorojë përmbushjen e detyrimeve/angazhimeve e tyre në ofrimin e shërbimeve cilësore; të shprehë drejtpërdrejtë tek autoritetet përkatëse opinionin e tij dhe t’u kërkojë atyre përmirësimet e nevojshme, si dhe të ndërveprojë me autoritetet përkatëse me qëllim përfitim të shërbimeve cilësore e të qëndrueshme. **VKQ i jep mundësinë autoriteteve vendore** të njohin më mirë nevojat dhe prioritetet e komunitetit në përgjithësi, si dhe të grupeve të veçanta të tij; të

¹ Marrë nga Manuali për Shoqërinë Civile “Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen”- Mbështetur nga Njësia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), Shtëpia Botuese IDEART, 2012 Tiranë

orientojnë më mirë burimet që kanë në dispozicion në përputhje me këto nevoja dhe prioritete të komunitetit, të rrisin kapacitetet e tyre, transparencën në qeverisje dhe të përmirësojnë cilësinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve që i ofrojnë komunitetit.

Procesi i Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen realizohet përmes disa etapave, të tilla si: (1) Vlerësimi për ndjekjen e të dhënave (gjetja dhe konsultimi i dokumenteve, materialeve dhe strategjive që lidhen me Bashkinë); (II) Vlerësimi komunitar për performancën (fokus grupe me qytetare të Bashkisë në zonën urbane dhe rurale); (III) Vlerësimi ose vetë-vlerësimi nga ofruesit e shërbimeve (intervista gjysme të strukturuar me autoritetet lokale); (IV) Takimi i drejtpërdrejt midis përfituesve dhe ofruesve (prezantim publik i gjetjeve dhe rekomandimeve nga ky proces dhe (V) Përgatitja e raportit me qëllim institucionalizimin e procesin, advokimin dhe monitorimin.

5. PËRSHKRIM I PROJEKTIT

Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen 2015

Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen në Bashkinë Vlorë u shtri në periudhën 2015-2016. I organizuar në prag të zgjedhjeve lokale, procesi i VKQ në vitin 2015 angazhoi qytetarët e bashkisë Vlorë dhe të komunave që do të përfshiheshin në të pas riorganizimit nga Reforma Administrative-Territoriale. Nevojat dhe prioritetet e dala nga qytetarët iu prezantuan kandidatëve për kryetarë bashkie me synimin e përfshirjes së tyre në axhendat dhe programet elektorale, për t'u përkthyer më pasë në programe dhe plane zhvillimore lokale.

Procesi u zhvillua përmes disa fazave, të cilat janë të detajuara si më poshtë:

Në fazën e parë u zbatua metodologjia e VKQ-së për nxjerrjen e prioriteteve të komunitetit (si burra edhe gra) në pesë njësi administrative (atëherë bashkitë Vlorë e Orikum, dhe komunat Novoselë, Shushicë dhe Qendër) sipas Reformës Territoriale. Gjatë kësaj faze, anëtarë të KKQV-së u informuan mbi procesin e VKQ-së si dhe për Reformën Administrative Territoriale. Në fokus-grupet e realizuara u nxorën problematikat e komunitetit sipas sistemit të vlerësimit.

Në fazën e dytë u punua me partitë politike dhe programet dhe platformat e tyre elektorale me anë të takimeve publike ndërmjet qytetarëve dhe kandidatëve për të adresuar prioritetet dhe problematikat e dala gjatë fazës së parë.

Gjatë fazës së tretë u realizuan debate qytetare nëpërmjet forumeve me kandidatët dhe fushatave ndërgjegjësuese.

Ndërsa **faza e fundit** u zbatua pas përfundimit të procesit zgjedhor, që u orientua rreth monitorimin dhe institucionalizimin e procesit të VKQ-së nëpërmjet trajnimeve të të zgjedhurve vendor dhe qytetareve.

Realizimi i këtij procesi në Vlorë nuk ishte i plotë, për shkak se nuk u zhvillua dot një takim publik i kandidatit (kryetari aktual i bashkisë) me qytetarët, por edhe vetë ai nuk paraqiti një dokument zyrtar ku të prezantohej platforma e tij. Meqenëse procesi u zhvillua dhe rekomandimet e qytetarëve përbëjnë bazën e punës katër-vjeçare të kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe stafit të tij, ekipi që realizoi këtë iniciativë, ka përgatitur një përmbledhje të progresit të bërë, bazuar në rekomandimet e vitit 2015 ndaj atyre të 2016, të cilat janë rekomandime afatgjata.

Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen 2016

Për të parë ecurinë e këtij procesi të nisur në vitin 2015, Komisioni Këshillimor Qytetar Vendor Vlorë realizoi monitorimin e rekomandimeve që qytetarët kanë adresuar ndaj Bashkisë Vlorë, përmes zbatimit të së njëjtës metodologji për vitin 2016. Ndërkohë është realizuar krahasimi në lidhje me rekomandimet e qytetarëve në 2015 ndaj rekomandimeve të 2016. Rezultatet përdoren në nivel vendor për të kërkuar llogari dhe përgjegjshmëri nga autoritetet vendore.






Procesi u zhvillua përmes disa fazave, të cilat janë të detajuara si më poshtë:

Skedat e vlerësimit: Faza përgatitore e projektit ishte shumë e rëndësishme për përcaktimin e aspekteve/fushave që do të mbulonte dhe treguesve që do të përmbante VKQ. Katër fushat e përzgjedhura ishin: (I) cilësia dhe efiçenca e shërbimeve publike, (II) qeverisja e mirë dhe demokracia lokale, (III) zhvillimi ekonomik dhe (IV) të drejtat e njeriut në nivel vendor. Bazuar në to u përcaktuan edhe 20 treguesit e performancës. U përgatitën tre lloje skedash specifike për qytetin, njësinë administrative dhe një përmbledhëse me vlerësimin e qytetareve dhe ofruesve të shërbimeve. Treguesit që u përdorën për Vlerësimin e Komunitetit për Qeverisjen janë:



Fokus grupet: Me synimin e marrjes së mendimit qytetar në muajin korrik u organizuan 5 fokus grupe me përfaqësues të komunitetit dhe banorë të qytetit Vlorë dhe njërive administrative Orikum, Novoselë, Shushicë dhe Nj.A Qendër. Në takime morën pjesë 66 pjesëmarrës (përfaqësues të Komisionit Këshillimor Qytetar Vlorë, OJQ, individë komunitarë që përfaqësonin grupe të marginalizuara, qytetarë aktivë, kryepleq fshatrash) të cilët me anë të pikëzimit vlerësuan performancën e bashkisë dhe identifikuan nevojat dhe prioritetet e qytetarëve. Në vlerësimin e komunitetit për qeverisjen procesi pati pjesëmarrje të balancuar gjinore 30 meshkuj dhe 36 femra. Gjatë realizimit të fokus grupeve me komunitetin, pjesëmarrësit u prezantuan me qëllimin dhe objektivat e projektit, informacione mbi zbatimin e Reformës Administrative-Territoriale, ndryshimi i kuadrit ligjor dhe mekanizmat që mbështesin pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Intervista gjysmë të strukturuar: Pas takimit me qytetarët u organizuan intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësues të Bashkisë, ku u ofruesit e shërbimeve vetë-vlerësuan përmes sistemit të pikëzimit shërbimet që ata ofrojnë për komunitetin. Intervistat përfshinë zv/kryetarin e bashkisë, drejtorinë e shërbimeve, drejtorinë e projekteve dhe administratorët e njërive Orikum, Novoselë, Shushicë dhe Nj.A Qendër. Shkalla e vlerësimit sipas pikëzimit që u përdor në Vlerësimin e Komunitetit për Qeverisjen si me qytetarët, ashtu edhe me bashkinë është si më poshtë:

Kriteret		Pikëzimi
Nuk ofrohet shërbim ose cilësia është shumë e dobët		1-Shumë keq
Shërbimi ofrohet, por cilësia është e dobët		2- Keq
Shërbimi ofrohet dhe është relativisht i mirë		3- Çka (mesatar)
Shërbimi ofrohet me cilësi të mirë		4- Mirë
Shërbimi ofrohet me cilësi të lartë		5- Shumë mirë

Analizimi i të dhënave: Moment shumë i rëndësishëm i VKQ është hedhja dhe analizimi i të dhënave nga fokus grupet dhe intervistat me ofruesit e shërbimeve. Gjatë kësaj faze është bërë edhe konsolidimi në një skedë i pikëzimit dhe gjetjeve nga qytetarët dhe ofruesit e shërbimeve. Pjesë thelbësore e punës ishte edhe konsultimi me dokumente/strategji dhe informacione të tjera që jepnin nje ide me të qartë të fushave dhe treguesve të analizuar.

Prezantimi publik: Faza e fundit e VKQ në Bashkinë Vlorë ishte prezantimi publik i procesit të vlerësimit. Ai u organizua në formën e një forumi publik me qytetarët e Vlorës. Përveç dy zv/kryetarëve dhe stafit të bashkisë, në takim morën pjesë edhe përfaqësues të Komisionit Këshillimor Qytetar Vlorë, OJQ, individë komunitarë që përfaqësonin grupe të marginalizuara, qytetarë aktivë, administratorë e kryepleq fshatrash të cilët morën pjesë në fokus grupet e organizuara. Takimi përfshiu një prezantim të gjetjeve nga ky proces, dhe në fund u ofruan rekomandimet që dolën nga takimet me qytetarët. Zv/Kryetari i Bashkisë vlerësoi procesin si një mundësi e mirë për të marr mendimin e qytetarëve dhe si një formë e mirë për të rritur bashkëpunimin dhe dialogun me ta në të ardhmen. Rekomandimet do të merren parasysh në hartimin e buxhetit të vitit pasardhës, si dhe do të bëhen pjesë e Planit Strategjik të Territorit që është në proces hartimi.

6. PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE

Siç u shpjegua më sipër në raport, në procesin e Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen u përfshinë qytetarët e njësisë administrative qendër Vlorë, Orikum, Novoselë, Shushicë dhe Nj.A Qendër. Paralelisht me ta u intervistuan edhe punonjësit e bashkisë/ofruesit e shërbimeve. Çështjet për të cilat u bë monitorimi dhe vlerësimi ishin të ngjashme me ato që u diskutuan nëpër fokus grupet me komunitetin, në mënyrë që të merrej informacion për çështje të njëjta si nga komuniteti, në rolin e përfituesit të shërbimeve, ashtu edhe nga pushteti vendor në rolin e ofruesit të shërbimeve publike. Më poshtë keni rezultatet e dala dhe analizuara nga ky vlerësim.

- a) **Cilësia dhe efiçenca e shërbimeve publike** - rrugë/ trotuare, ndriçim, pastrim, gjelbërim, furnizim me ujë të pijshëm dhe kanalizime, kanalet kulluese e vaditëse, pyjet e kullotat

CILËSIA DHE EFIÇENCA E SHËRBIMEVE PUBLIKE		
	TË INTERVISTUARIT	PIKËZIMI
QYTET	Qytetarët	2.7
	Ofruesit e shërbimeve	3.7
NJËSI ADMINISTRATIVE	Qytetarët	2.1
	Ofruesit e shërbimeve	2.6

- b) **Demokracia vendore – mirëqeverisja** – informimi dhe komunikimi, transparenca në vendimmarrje, pjesëmarrja në vendimmarrje

DEMOKRACIA VENDORE – MIRËQEVERISJA		
	TË INTERVISTUARIT	PIKËZIMI
QYTET	Qytetarët	3.3
	Ofruesit e shërbimeve	4.7
NJËSI ADMINISTRATIVE	Qytetarët	3.0
	Ofruesit e shërbimeve	3.8

- c) **Zhvillimi ekonomik vendor** - planifikimi strategjik, nxitja e biznesit, nxitja e punësimit, mbledhja e të ardhurave dhe planifikimi i buxhetit

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR		
	TË INTERVISTUARIT	PIKËZIMI
QYTET	Qytetarët	2.3
	Ofruesit e shërbimeve	3.6
NJËSI ADMINISTRATIVE	Qytetarët	2.1
	Ofruesit e shërbimeve	3.1

- d) **Të drejtat e njeriut në nivel lokal** - gratë, grupe me nevoja të veçanta, romët dhe egjiptianët, mbrojtja nga diskriminimi

TË DREJTAT E NJERIUT NË NIVEL LOKAL		
	TË INTERVISTUARIT	PIKËZIMI
QYTET	Qytetarët	2.6
	Ofruesit e shërbimeve	3.7
NJËSI ADMINISTRATIVE	Qytetarët	2.4
	Ofruesit e shërbimeve	3.1

Përveç sistemit të pikëzimit pjesëmarrësit në vlerësim patën mundësinë të jepnin edhe komente e sugjerime/rekomandime. Më poshtë po rendisim disa prej gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore, që qytetarët dhe ofruesit e shërbimeve kanë bërë në Bashkinë Vlorë.

7. GJETJET KRYESORE PËR PERIUDHËN 2015-2016

7.1 GJETJET NË QYTET:

- Ndërsa në 2015, qytetarët rekomandonin në makro rregullimin e rrugëve kryesore dhe dytësore, vendosjen e sinjalistikës rrugore (semaforë dhe vija të bardha), gjatë 2016 qytetarët kanë vlerësuar ndryshimin, ndërkohë që aktualisht në Bashkinë e Vlorës kanë startuar investime madhore, dhe/ose janë gjatë fazës së implementimit.
- Shtimi i zonave dhe koshave për grumbullimin e mbeturinave në të gjithë bashkinë Vlorë. Gjatë 2016, firma që ofron shërbimin e pastrimit ka rritur ndjeshëm performancën e saj duke ofruar shërbim më të mirë për qytetarët.
- Bërja e landfill. Edhe pse gjatë 2015 është premtuar se do të nënshkruhej kontrata për landfill në qytet, ende nuk ka informacione për situatën ku ndodhet ky rekomandim për 2016.
- Rekomandim i 2015 ka qenë dhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbra në qytet. Përgjatë 2016 në qytet janë shtuar ndjeshëm sipërfaqet e gjelbra, problem mbetet ende zëvendësimi i palmave në rrugën kryesore.
- Në bazë të rekomandimeve për rehabilitimin e sistemit të furnizimit me ujë në qytet, vendosjen e ujëmatësve dhe të eliminimit të faturave aforfe, ende nuk ka ndryshime të situatës për vitin 2016.
- Mbi rekomandimet e 2015 për të përfshirë komunitetin në buxhetimin me pjesëmarrje dhe gjinor, vëmë re se gjatë fundit të vitit 2015 dhe gjatë 2016, ky proces është zhvilluar bashkë me organizata lokale. Janë planifikuar shpenzime të mbështetura në nevojat e komunitetit (gra, grupe të marxhinalizuara).
- Gjatë 2015 qytetarët kanë rekomanduar që Bashkia Vlorë të vërë në funksion ligjin për informimin dhe konsultimin e publikut dhe të lehtësojë gjithë procedurat e brendshme në funksion të këtij ligji që të bëhet i aksesueshëm nga qytetarët. Perceptimi i qytetarëve për performancën e bashkisë ndaj këtij rekomandimi vlerësohet pozitivisht.
- Qytetarët rekomandojnë rritjen e takimeve me publikun dhe grupet e interesit nga ana e stafit të bashkisë. Gjatë 2016 janë realizuar disa takime dhe është rifirmosur marrëveshja e bashkëpunimit me KKQV-në dhe/ose me OJQ të tjera.
- Ndërsa në 2015 kërkohet një studim i plotë i potencialeve ekonomike të Bashkisë së re të Vlorës dhe orientimet për perspektivat e saj të zhvillimit ekonomik, sot është në fazën përfundimtare realizmi i Planit të Përgjithshëm Vendor Vlorë.

- Qytetarët në 2015 rekomandonin ngritjen e një Këshilli Ekonomik Konsultativ pranë Kryetarit të Bashkisë, ende sot nuk ka një strukturë të tillë, por zakonisht anëtarë të shoqërisë civile dhe ekspertë të këtij sektori ftohen për të dhënë mendimet e tyre për çështjet me rëndësi publike.
- Informatizim i plotë i shërbimeve financiare nën varësinë e Bashkisë Vlorë. Ky rekomandim është duke u përmirësuar vazhdimisht nga ana e institucionit.
- Për rekomandimin e prokurimit të shërbimeve sociale që ofrohen për kategori të margjinalizuara në Bashkinë Vlorë, ende nuk ka ndonjë kontratë prokurimi, por ka bashkëpunime financiare me organizata të ndryshme që punojnë në këtë sektor.
- Nëse gjatë 2015 kërkohej ofrimi i shërbimeve cilësore përmes ngritjes së një qendre multifunksionale për shërbimet sociale. Së shpejti një qendër e tillë do të hapet pranë këtij institucioni në bashkëpunim me donatorë dhe organizata
- Nëse gjatë 2015 rekomandohej aktivizimi i tavolinave të bashkëpunimit social, duke mbajtur në fokus të veçantë diskutimet për çështje të barazisë gjinore dhe nxitjen e përfaqësimit të grave dhe vajzave në institucionet lokale vendim-marrëse, përgjatë 2016, kemi shembuj pozitivë të këtyre rekomandimeve, ku mund të përmendim grupet e punës për çështjet e grave, fëmijëve, etj.
- Gjatë 2015 rekomandohej të hartohej Planit Social të Zonës për periudhën 2016-2018. Aktualisht është duke u konsideruar hartimi i planeve specifike për të rinjtë, romët dhe egjiptianët, gratë, për fëmijët etj

7.2 GJETJET NË NJËSITË ADMINISTRATIVE

- Nëse gjatë 2015 qytetarët kërkonin rrugë të reja ose/dhe mirëmbajtje e rrugëve ekzistuese në fshatra ose në rrugët ndërlidhëse midis fshatrave, nga analiza e buxhetit të bashkisë, ende nuk ka përmirësime konkrete të situatës.
- Nj.A e Bashkisë Vlorë kanë probleme me shërbime të cilat janë mbuluar në të shkuarën nga komuna dhe sot janë të pazgjidhura nga bashkia (pastrimi, transporti, kullotat, etj.)
- Banorët shprehen se mungon prezenca dhe takimet me bashkinë që nga koha e zgjedhjeve.
- Banorët rekomandojnë që të pastrohen/rehabilitohen kanalet e kullimit dhe vaditjes.
- Ka nevojë për programe /mbështetje që lidhen me bujqësinë/agrobiznesin/blegtorinë apo turizmin.

8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

8.1 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME PËR QYTETIN

8.1.1 Shërbimet Publike – Cilësia dhe Efiçenca

Infrastruktura rrugore

Aktualisht qytetarët vlerësojnë investimet në infrastrukturë që Bashkia Vlorë ka ndërmarrë. Gjithsesi, ata kërkojnë ndërhyrje në disa prej rrugëve të qytetit, kryesisht në zonat informale.

- Rekomandohet që bashkia të ushtrojë presion për përfundimin e Lungomares dhe kryerja e punimeve të jetë cilësore nga firmat zbatuese.
- Rekomandohen ndërhyrje në “Rrugën e Unazës” Rrugën “Pelivan Leskaj”-“Sazani”, Rruga “Zigur Lelo”, Rruga “Ramize Gjebrea”, etj.
- Rekomandohen riparime në rrugët dytësore.
- Rekomandohet të kontrollohet rreptësisht cilësia e punimeve në rrugë.
- Punimet në rrugë duhet të planifikohen që mos të pengojnë qarkullimin e sigurt të qytetarëve.

Sistemi i ndriçimit

Qytetarët rekomandojnë të punohet më shumë për mirëmbajtjen e këtij shërbimi jo vetëm në sheshet dhe rrugët kryesore; të ndriçohen rrugët e lagjeve dhe sidomos rrugët ku po bëhen punime të cilat janë të rrezikshme.

Shërbimi i pastrimit

- Rekomandohet të rritet cilësia e pastrimit të qytetit.
- Rekomandohet të shtohen koshat e mbeturinave pasi ata që janë, nuk mjaftojnë dhe të vendosen kosha për mbledhjen e diferencuar.

Shërbimi i gjelbërimit

Qytetarët kanë perceptim pozitiv për punën e bashkisë në lidhje me gjelbërimin

- Janë mbjelle pemë të ndryshme dekorative, problem mbetet bulevardi kryesor i cili ka nevojë për heqjen e palmave të vjetra dhe zëvendësimin me të reja.
- Duhet të krijohen hapësira të gjelbra në çdo zonë, që të jenë lehtësisht të aksesueshme për qytetarët, gjithashtu dhe parqe për fëmijët.

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet

- Rekomandohet përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe heqja e kufizimeve, sidomos në stinën e verës kur uji është i nevojshëm për mbarëvajtjen e turizmit.
- Rekomandohet të vendoset në funksion impianti i trajtimit të ujërave të zeza.
- Ka nevojë për ndërhyrje urgjente në kanalizimet e qytetit, ndërkohë që projekti është duke u realizuar, kthimi i rrugëve në gjendje të mirë mbetet shqetësim i qytetarëve.

8.1.2 Demokracia Vendore dhe Mirëqeverisja

Informimi dhe komunikimi:

- Rekomandohet të rritet komunikimi ndërmjet qytetarëve dhe bashkisë.
- Rekomandohet përdorimi i buxhetimit me pjesëmarrje dhe buxhetimi gjinor të zbatohet në të gjitha Nj.A
- Zyra e informacionit duhet të jetë me një ndalesë për të shmangur burokracitë.

Transparenca në vendimmarrje:

- Informacionet në faqen e bashkisë duhet të jenë më koherente.
- Vendimet e Këshillit Bashkiak të jenë të përditësuara
- Këndi për shpalljen e njoftimeve duhet të jetë i përditësuar me informacion.

Pjesëmarrja në vendimmarrje:

- Të trajtohet stafi i bashkisë në lidhje me ligjin për informimin publik dhe për njoftimin dhe konsultimin publik.
- Duhet të theksohet vazhdimisht që mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura për qytetarët. Bashkia duhet të promovojë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

8.1.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor

Planifikimi strategjik:

- Bashkia është në procesin e hartimit të strategjisë së territorit, që përbën dhe dokumentin kryesor mbi të cilin bazohet planifikimi strategjik për vitet e ardhshme. Rekomandohet një fushatë e mirëfilltë konsultimi paraprak dhe informimi për qytetarët të cilët do të përfitojnë nga planifikimi strategjik.

Nxitja e bizneseve:

- Të hapet një dyqan/ punishte që të integrojë punën dhe shitjen e grave artizane
- Rekomandohet që bashkia të zhvillojë programe për nxitjen e punësimit në bashkëpunim me institucionet e tjera.
- Rekomandohet rritja e bashkëpunimit me biznese private për zhvillimin e ekonomisë vendore.

Mbledhja e të ardhurave dhe planifikimi i buxhetit:

- Rekomandohet që qytetarët të informohen më konkretisht ku shkojnë taksat e tyre.

8.1.4 Respektimi dhe zhvillimi i të drejtave të njeriut në nivel lokal

Gratë:

- Vlerësohet puna që bën bashkia, rekomandohet që krahas punës shumë të mirë për përfshirjen e grave në vendimmarrje kryesisht në pozicione drejtuese, të punojë më tepër për punësimin e grave.

Grupe me nevoja të veçanta:

- Vlerësohet puna që Bashkia e Vlorës bën për grupet me nevoja të veçanta përmes organizatave dhe donatorëve të ndryshëm.

- Rekomandohet që bashkia të punojë më tepër për për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave, si dhe përfshirjen sociale për grupet me nevoja të veçanta.
- Rekomandohet rritja e bashkëpunimit të bashkisë me OJF lokale për ti garantuar qytetarëve të gjitha shërbimet e karakterit social.
- Duhet të ofrohet zgjidhje për të pastrehët.

Romët dhe Egjiptianët:

- Hartimi i një strategjie ose plani lokal për integrimin e komunitetit rom dhe egjiptian
- Krijimi i mundësive për punësim për romët dhe egjiptianët

Mbrojtja nga diskriminimi:

- Rekomandohet që bashkia të realizojë fushata ndërgjegjësimi me synim ndërveprimin social-kulturor dhe thyerjen e barrierave diskriminuese.

8.2 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME PËR NJËSITË ADMINISTRATIVE

8.2.1 Shërbimet Publike – Cilësia dhe Efiçenca

Infrastruktura rrugore:

- Në Nj.A. Novoselë qytetarët rekomandojnë investime përmirësuese në rrugën Pompa-Akërnj-Aliban dhe investim në rrugën hyrëse të Akërnjës.
- Në Nj.A. Orikum qytetarët rekomandojnë investime në pjesën e poshtme në rrugën e fshatit Radhimë.
- Në Nj.A. Shushicë rekomandohet ndërhyrje urgjente për rrugën kryesore që lidh Vlorën me këtë njësi.
- Qendra e fshatit Lllakatund ka nevojë për rikonstruksion .
- Ka nevojë për shtrim të rrugëve të brendshme në Lllakatund.
- Qendra shëndetësore ka nevojë për rikonstruksion.
- Rekomandohet shtrimi i rrugëve lidhëse që çojnë në fshatat Bunavi dhe Grabian.
- Rekomandohet ndërhyrje në rrugët lidhëse me fshatrat Mekat dhe Çepirat.
- Rekomandohet ndërhyrje për ndriçimin në rrugën nga Alibani deri në Dëllinjë.
- Rruga e Mifolit ka nevojë për investime.
- Të mirëmbahet rruga Tre Vllazër-Skroftinë.

Transporti publik:

- Rekomandohet të vendoset shërbimi i transportit publik të paktën në Nj. A. Novoselë.

Pastrimi:

- Kërkohe vendosja dhe shtimi i numrit të koshave të mbeturinave.
- Kërkohe shtimi i fondeve për përmirësimin e këtij shërbimi.

Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet:

- Rekomandohen investime në tubacione
- Rekomandohet përmirësimi i cilësisë së ujit dhe furnizimit me ujë dhe mosndërprerja e ujit në zonat bregdetarë gjatë sezonit të verës.
- Rekomandohet përdorimi i burimeve të shumta të ujit në Shushicë për furnizimin me ujë të pijshëm.
- Rekomandohet shtrirja e rrjetit të ujit të pijshëm në Bunavi.

Pyjet dhe kullotat:

- Banorët rekomandojnë investime për mirëmbajtje në këtë sektor.
- Kanalet kulluese/ vaditëse:
- Qytetarët rekomandojnë pastrimin e kanaleve me urgjence sepse ju neojiten për vaditje

8.2.2 Demokracia Vendore dhe Mirëqeverisja

Transparenca në vendimmarrje:

- Këndi i njoftimeve në çdo njësi administrative duhet të jetë funksional dhe i përditësuar .
- Informimi dhe komunikimi:
- Në çdo Nj. A. duhet të ketë kënde me hapësirë të mjaftueshme për shpalljen e njoftimeve dhe të vendoset informacion i përditësuar.
- Rekomandohet të rritet komunikimi ndërmjet qytetarëve dhe bashkisë.

Pjesëmarrja në vendimmarrje:

- Sugjerohet zbatimi i ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik.
- Rekomandohet të bëhen njoftime gjithëpërfshirëse për pjesëmarrje në takimet dhe konsultimet publike. Gjithashtu mendimet e qytetarëve duhet të protokollohen.
- Në Nj. A. Shushice qytetarët kërkojnë takim drejtpërdrejtë me kryetarin e bashkisë pasi ndjehen të lënë pas dore.

8.2.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor

Nxitja e biznesit/punësimit:

- Rekomandohet që bashkia të krijojë programe/ inçentiva për mbështetjen e fermerit.
- Rekomandohet asistencë nga bashkia kundrejt fermerëve për krijimin e kooperativave bujqësore.
- Mbledhja e të ardhurave dhe planifikimi i buxhetit:
- Rekomandohet që qytetarët të informohen mbi detyrimin e tarifave dhe taksave vendore dhe të vihen në dijeni kur ka ndryshime.
- Rekomandohet që qytetarët të informohen më konkretisht ku shkojnë taksat e tyre.

8.2.4 Respektimi dhe Zhvillimi i të Drejtave të Njeriut në Nivel Lokal

Gratë:

- Rekomandohen fushata ndërgjegjësimi për dhunën ndaj grave në bashkëpunim me OJF vendore.
- Rekomandohet të gjejnë mbështetje prioritetet e dala nga forumet e grave në njësitë administrative.
- Rekomandohet organizimi i panaiereve ku mund të shiten produktet artizanale.
- Rekomandohet të mbështet transporti i grave në nevojë për trajnimin e tyre pranë qendrës së formimit profesional.

Grupe me nevoja të veçanta:

- Rekomandohet që bashkia të punojë më tepër për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave si dhe përfshirjen sociale për grupet me nevoja të veçanta.

Romët dhe Egjiptianët:

- Kërkoheq që bashkia në bashkëpunim me bizneset private te ndërmarrë programe për punësimin e Romëve.
- Ndërtesa është duke iu shembur në Llakatund
- Banesa sociale

Mbrojtja nga diskriminimi:

- Rekomandohet që njësitë administrative të zbatojnë ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi dhe të udhëhiqen nga parimet e këtij ligji në të gjitha shërbimet që ofrojnë për qytetarët
- Ndërkohë mund të realizohen fushata ndërgjegjësimi me synim ndërveprimin social-kulturor dhe thyerjen e barrierave diskriminuese.

RRETH QENDRËS ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM

E themeluar në vitin 1994, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC) është një organizatë jo fitimprurëse, jo partiake, me mbi 20 vjet eksperiencë në punë kërkimore, edukim publik, asistencë për zhvillim kapacitetesh, monitorim dhe avokim. GADC promovon zhvillimin demokratik dhe mirëqeverisjen me një fokus të veçantë në çështjet e barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale. GADC është një organizatë lider në Shqipëri dhe në rajon, e mirënjohur për rolin e saj në prezantimin e çështjeve të rëndësishme në lidhje me të drejtat e grave, siç është dhuna me bazë gjinore dhe trafikimi i personave.

GADC është e njohur për zhvillimin e metodologjive të ndryshme për fuqizimin përmes zhvillimit ekonomik të grupeve vulnerabël, avokimit për çështje themelore ligjore e politika të rëndësishme siç janë Ligji “Për dhunën në marrëdhëniet familjare” apo “Ligji kundër diskriminimit”, Barazia Gjinore apo përfaqësimi i grave në politikë e vendim marrje. Prezantimi i çështjeve të buxhetimit gjinor në nivel lokal dhe qendror si dhe përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje janë dy çështje për cilat GADC ka zhvilluar e zbatuar metodologji të veçanta të cilat sollën ndryshime të rëndësishme që adresojnë pabarazitë dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël në Shqipëri.

Që nga fillimi GADC ka zbatuar shumë projekte, të cilat kanë ndikuar në jetët e qindra pjesëmarrësve në aktivitetet e zhvilluara në të gjithë Shqipërinë. GADC ka një historik të gjatë bashkëpunimi të suksesshëm me aktorë të ndryshëm, përfshirë një numër të madh organizatash shqiptare, institucionesh publike në nivel qendror e lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, sektorit privat, medias, akademisë etj. Disa nga aktorët kyç partnerë të GADC-së janë UN Women, UNDP, BE, Ambasada e SHBA, USAID, OSBE, Dhoma të Tregtisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, bashki të ndryshme etj.

GADC fuqizohet në punën e saj nga rrjeti i gjerë i bashkëpunëtorëve, ekspertëve dhe trajnerëve kombëtarë e ndërkombëtarë me formim të pasur akademik. GADC punon të shpërndajë sa më shumë informacion dhe të kthehet në një platformë për ndarje eksperiencash e njohurie me të gjithë e në të gjithë vendin.



VLERËSIMI I KOMUNITETIT PËR QEVERISJEN

RAPORT BASHKIA VLORË